SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Njoftim për vende të lira pune.

8 Vende vakante në Pozicionin "Punonjës Shërbimi i Sistemit të Parkimit dhe Biletarisë" me kontratë shërbimi me afat të caktuar në SUT.

Kandidatët për vendet vakante "Punonjës Shërbimi i Sistemit të Parkimit dhe Biletarisë" duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë përfunduar arsimin e mesëm.
2. Preferohet të kenë përvojë pune në shërbim klienti, arkë, recepsion apo pozicione pune të ngjashme.
3. Të kenë njohuritë bazë në përdorimin e kompjuterit.
4. Të kenë aftësi të mira për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të kenë bashkëpunim në grup.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin këto dokumenta si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim, drejtuar Institucionit.
2. Curriculum Vitae (CV).
3. Diploma e shkollës së mesme + listë notash (kopje e noterizuar).
4. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit. (MASR)
5. Dëshmi e penalitetit.
6. Raport Mjekësor për aftësi në punë.
7. Fotokopje e kartës së identitetit.
8. Librezën e punës, n.q.s ka (kopje e noterizuar) ose Vërtetim mbi bazën e vlerësuar nga e – Albania.

Të interesuarit të paraqesin dokumentat, pranë Sektorit të Sekretari/Protokollit në Spitalin Universitar të Traumës brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e publikimit të këtij njoftimi**.**